

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – kolegji i përbërë nga gjyqtaret: Shqipe Qerimi kryetare e kolegjit, Gani Zabeli dhe Ferit Osmani anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Hysni Ismaili, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.H. nga fshati ..., Komuna ..., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor, nga nenin 188 par. 1 nën par. 1.4 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti, P.nr.187/2015 të datës 13.05.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 21.09.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti, P.nr.187/2015 të datës 13.05.2016, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Viti, me aktgjykimin P.nr.187/2015 të datës 13.05.2016, të akuzuarin L.H. e ka shpallur fajtor për veprën penale lëndim i lehtë trupor, nga nenin 188 par. 1 nën par. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 250 (dyqindpesëdhjetë) €, të cilin dënim është obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën i njëjti do t'i zëvendësohet në dënim burgu në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, ashtu që 20 € të gjobës do t'i llogariten në një ditë burgim. Është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. I dëmtuari D.S., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil. Për të akuzuarin Xh.H., konform nenit 363 par. 1 pika 1.1 të KPPK-së, përkitazi me veprën penale lëndim i lehtë trupor, nga nenin 188 par. 1 nën par. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së është refuzuar aktakuza, për shkak se Prokurori në shqyrtimin gjyqësorë është tërhequr nga akuza.

Kundër këtij aktgjykimi, për pjesën gjyquese në afatin ligjor ankesë ka ushtruar Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe atë vetëm sa i përket vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ankesën ta aprovoj si të bazuar, aktgjykimin i ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarit në së paku dënim me gjobë shumë prej një mijë €, apo dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesë muaj.

Brenda afatit ligjorë, përgjigje në ankesën e Prokurorit ka paraqitur edhe i akuzuari L.H., me propozim që ankesa e Prokurorit të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokurori i Apelit në Prishtinë me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.843/2016, datë 29.06.2016, ka propozuar që ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan të aprovet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i lartë me gjobë.

Gjykata e Apelit pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitat e nenit 394 të KPPK-së, dhe pasi vlerësoj pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe ligjit penal, me gjithë atë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt konform nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Meqë me ankesë nuk kontestohet as gjendja faktike ajo nuk qe objekt vlerësimi i kësaj gjykate, prandaj aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Sa i përket vendimit për dënim, në ankesë Prokurori pretendon se gjykata e shkallës së parë të akuzuarit L.H. edhe për kundër vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe atë me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, të njëjtit nuk i ka shqiptuar dënimin e merituar sipas ligjit, sepse ka shqiptuar dënim me gjobë edhe pse sipas rrethanave të rastit konkret, përkatësisht pasojave të shkaktuar me këtë vepër penale, rrezikshmërisë shoqërore, shkallës së përgjegjësisë penale dhe natyrës së lëndimeve të shkaktuara të dëmtuarit, ky dënim si i tillë është jo proporcional dhe jo adekuat, dhe se me një dënim të tillë nuk do të mund të ndikoj tek i akuzuari dhe tek të tjerët që në të ardhmen të mos kryejnë vepra penale, andaj i propozon kësaj gjykate që aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të njëjtit t'i shqiptoj dënim me gjobë së paku 1000 €, ose dënim me burg efektiv në kohëzgjatje prej 5 muaj.

I akuzuari L.H., në përgjigjen në ankesën e Prokurorit thekson se dënimi i shqiptuar të njëjtit nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë, pasi që gjykata ka analizuar provat e administruara dhe pranimin e fajësisë nga ana ime si i akuzuar dhe rrethanat tjera lehtësuese dhe ato rënduese, po ashtu pretendon se Prokurori i ka nënvlerësuar rrethanat lehtësuese, sepse nuk ka pasur parasysh faktin se kjo që ka ndodh ka qenë e rastit prandaj dënimi i shqiptuar të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë do të arrij plotësisht qëllimin e dënimit, andaj i propozon Gjykatës së Apelit që ankesën e Prokurorit ta refuzoj si të pabazuar dhe aktgjykimin e ankimuar ta vërtetoj.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e mësipërme ankimore të Prokurorit për një dënim me gjobë në shumë prej 1000 €, apo dënim me burg efektiv deri në 5 muaj, nuk janë të bazuara dhe nuk përkojnë me autorizimet ligjore të cilat i ka Prokurori si palë e barabartë me të tjerët në procedurë. Gjukata e shkallës së parë konform dispozitave të nenit 74 të KPRK-së, i ka vlerësuar rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, me ç'rast si rrethana lehtësuese në anën e të akuzuarit ka marrë parasysh faktin se i njëjti më parë nuk ka qenë i gjykuar, qëndrimin e tij korrekt në gjykatë, se është pënuar për veprën të cilën e ka kryer dhe se ka deklaruar që në të ardhmen nuk do të përsëris një vepër të tillë apo të ngjashme, si dhe faktin se me të dëmtuarin asnjë herë më parë nuk kanë pasur kurrfarë mosmarrëveshje dhe se me ndihmën e prindërve ata ishin pajtuar duke i kërkuar falje të dëmtuarit, ndërsa si rrethana rënduese gjykata e shkallës së parë ka pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore, si dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuarit.

Kolegji penal i kësaj gjykate, vlerësimin e këtillë të rrethanave lehtësuese dhe rënduese të vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë e pranon si të drejtë dhe të bazuar në ligj, prandaj duke pas parasysh të gjitha rrethanat që i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, faktin se rrethanat e theksuara rënduese të pretenduara në ankesën e Prokurorit kanë qenë objekt vlerësimi nga ana e gjykatës së shkallës së parë, e me qenë se në ankesë nuk është theksuar ndonjë rrethanë posaçërisht të re rënduese dhe e cila nuk ka qenë objekt vlerësimin nga ana e gjykatës së shkallës së parë, pastaj duke vlerësuar mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, rrethanat lehtësuese të cilat i ka konstatuar gjykata e shkallës së parë dhe atë se i akuzuari është pajtuar me të dëmtuarin, si dhe duke marrë si rrethanë veçanërisht lehtësuese faktin se i dëmtuari nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale dhe nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike, si dhe duke pasur parasysh edhe thëniet e precizuara në përgjigjen në ankesën e Prokurorit nga ana e të akuzuarit se i njëjti e ka pranuar fajësinë (edhe pse në fakt gjatë shqyrtimit gjyqësorë të datës 22.03.2016, e as në fjalën përfundimtare një pranim i tillë nuk është bërë, për çka gjykata edhe ka administruar provat në shqyrtimin gjyqësorë), kjo gjykatë vlerëson se dënimi të cilin të akuzuarit ia ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, posaçërisht duhet të jetë në funksion të preventivës gjenerale dhe individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se

me dënimin e shqiptuar me gjobë të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë, do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Aktgjykimi i ankimuar sa i përket pjesës refuzuese përkitazi me të akuzuarin Xh.H. për veprën penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par. 1 nën par. 1.4 lidhur me neni 31 të KPRK-së, ngel i pashqyrtuar, ngase për këtë pjesë nuk ka pasur ankesë.

Nga sa u tha më lartë, konform dispozitës së neni 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.801/2016 datë 21.09.2016

Bashkëpunëtor profesional
Hysni Ismaili

Kryetare e kolegjit
Shqipe Qerimi

Anëtarët e kolegjit

Gani Zabeli
Ferit Osmani